

KONKURS

Për pjesëmarrës në Akademinë Politike të dhjetën me radhë për demokraci sociale në vitin 2019

Akademia politike është projekt arsimor, i dizajnuar si kurs dhe trajnim akademik. Qëllimi kryesor i Akademisë është që t'i edukoj dhe trajnoj individët të cilët ndajnë vlerat socialdemokrate dhe të cilët në aktivitetet e përditshme formojnë dhe ndikojnë mbi vendimet politike në Maqedoni.

Akademia Politike do t'u mundësoj pjesëmarrësve njohuri teorike, por edhe aftësi dhe shkathtësi praktike në fushën e sistemit politik, ideologjisë socialdemokrate, menaxhmentit politik dhe partiak dhe komunikimit politik dhe marrëdhëniet me publikun. Këto qëllime do të realizohen në kuadër të katër apo pesë cikleve të seminareve tre ditore gjatë vikendeve mbi fushat e lartpërmendura në periudhë prej muajit mars deri në muajin tetor të vitit 2019. Seminari i parë do të mbahet në mes të marsit.

Kushtet për pjesëmarrje

Të drejtë për aplikim për pjesëmarrje në Akademi ka:

1. Çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë;
2. Të moshës prej 21 deri 40 vjeç;
3. Është i angazhuar ose dëshiron të jetë aktiv në jetën shoqërore dhe politike në Maqedoni;
4. Ndanë vlerat socialdemokrate politike, ekonomike, sociale dhe shoqërore;
5. Ka njohuri themelore mbi shkencat shoqërore dhe terminologjinë e saj;
6. Njohje të gjuhës angleze.

Dokumentacion i nevojshëm për pjesëmarrje

1. Biografi me kontakt dhe të dhëna
2. Letër motivuese

Përzgjedhja e kandidatëve

Kandidatët do të përzgjidhen në bazë të arritjeve personale (përfshirë edhe arsimin akademik, arsimin joformal, përvojë pune dhe praktikë) të shënuara në biografinë dhe letrën motivuese, si dhe përkatësia etnike, fetare, gjinore, rajonale dhe diversiteti social në Maqedoni. Gjithë kandidatët e paraqitur do të njoftohen për

rezultatet e përzgjedhjes më së voni gjer më 6 mars të vitit 2019 përmes postës elektronike. Pjesë e kandidatëve të përzgjedhur mund të ftohen në intervistë gojarisht në periudhë 7-8 mars të vitit 2019.

Dokumentet e paplotësuara nuk do të merren parasysh!

Dorëzimi i dokumentacionit

Dokumentacioni për aplikim duhet dorëzuar më së voni gjer më **24 shkurt të vitit 2019** në e-mail: pa@progres.org.mk

JU LUTEMI PA THIRRJE TELEFONIKE!